


SPITEX Sense

Këshilla për nëna dhe baballarë



Këshilla për prindërit e foshnjave dhe
Fëmijëve të vegjël deri 5. vjeç

Këshilla për nëna dhe baballarë

Është një ofertë vullnetare brenda sistemit shëndetësor dhe u ofrohet të gjithë personave të interesuar që kujdesen për foshnje dhe fëmijë të vegjël deri në moshën 4 vjeçare.

Ne

- këshillojmë, vërtetojmë dhe ju përcjellim në **detyrën tuaj të re**.
- ju këshillojmë për **dhënien e gjirit** dhe **problemet gjatë dhënies së gjirit** duke marrë parasysh dëshirat tuaja personale.
- vëzhgojmë dhe vlerësojmë së bashku me ju **zhvillimin e** foshnjës tuaj dhe fëmijës së vogël.
- e diskutojmë me ju përshtatjen individuale të **ushqyerjes** së fëmijës tuaj.
- ju përkrahim të **kujdeseni** për fëmijën tuaj të shëndoshë, por edhe kur ai është i sëmurë.
- diskutojmë me ju pyetjet e një dite të zakonshme në **edukim**, si në lidhje me problemet e **gjumit** etj.
- ju udhëzojmë në lidhje me **kontrollat parandaluese mjekësore, vaksinat** etj.
- ju japim **adresat kontaktuese** të shërbimeve tjera **profesionale dhe këshilluese**.

Ju

keni mundësinë të merrni pjesë në shërbimet tona të poshtëshënuara, që ne ju ofrojmë:

- **Vizita spitalore**

Për të realizuar kontaktin e parë, ne ju vizitojmë pas lindjes në spital (Spitali Kantonal dhe Daler) ose ju kontaktojmë me telefon në shtëpi.

- **Këshilla me telefon**

Ju mund të na kontaktoni me telefon, nëse keni pyetje ose për të lënë takim, nga e hëna në të premten (**koha dhe numri i telefonit, shih fletën bashkangjitur**).

- **Vizitat në shtëpi**

Bëhen, me kërkesën tuaj, pas lindjes së fëmijës. Në rrethin tuaj të besueshëm, ne mund të njihemi mes veti dhe të bisedojmë për pyetjet që mund të keni.

Vizita të tjera në shtëpi, mund të organizohen, sipas nevojës.

- **Vend këshillimet**

Në komuna të ndryshme japim këshilla rregullisht. (**Koha dhe vendi, shih fletën bashkangjitur**)

Ju mund të vini zakonisht me lajmërim paraprak (me përjashtime, shih fletën bashkangjitur) dhe do të këshilloheni individualisht.

Ne ua bëjmë me dije, se këshillimet tona i zhvillojmë në gjuhën gjermane ose atë frënge. Mirëpo, ju mund të organizoni një person përcjellës për përkthim.

Albanisch – Shqip

Çfarë duhet të dini përveç të tjerash

- Ne disponojmë kualifikim themelor për infermiere të diplomuara në pediatri dhe kemi përvojë pune. Në një trajnim dyvjeçar shoqërues në profesion, ne kemi marrë diplomën e lartë profesionale për këshillëdhënëse për nëna HFD/NDS. Përmes kualifikimeve të mëtejshme, ne i aktualizojmë përherë kompetencat tona profesionale.
- Këshillimet janë të besueshme. Ne gratë në këtë profesion i nënshtrohemi detyrimisht ruajtjes së sekretit.
- Ne jemi të punësuar nga shoqata SPITEX Sense.
- Shpenzimet mbulohen nga kontributet e organizatave në qarkun Sense për sa vijon: Komunitat, subvencionet e kantonit Freiburg, famullitë, shoqatat vendore të grave, bashkësitë e grave dhe nënave si dhe përmes ndihmave bamirëse dhe donacioneve.

Mütter- und Väaterberatung SPITEX Sense, Clientis Sparkasse Sense, 1712 Tafers.

Konto Nr. 16 3.213.683.08. PC 17-97-3, Clearing 6186

IBAN CH9206186016321368308

- Nëse nuk jeni të kënaqur me këshilla (përmbajta, forma, rrethanat etj.), ose konstatooni mangësi vendimtare, mund ti drejtoheni me shkrim udhëheqësit të SPITEX Sense, i cili do ti shqyrtoj kërkesat tuaja.

Adresa jonë:

Mütter- und Väaterberatung SPITEX Sense, Spitalstrasse 1,
1712 Tafers.

muetterberatung@spitexsense.ch

www.spitexsense.ch

